

Specifikimet Teknike

RAKORDERITE PP

Rakorderite sherbejne per bashkimin dhe pershtatjen e tubave ose rakorderive plastike me permasa te ndryshme. Trupi i rakorderive te jete material Polipropilen me rezistence mekanike te larte. Te suportojne presionin 16 bar, dhe per kete te jene te testuara sipas standarteve ISO 17885, ISO 1167-1, ISO 1167-4, ISO 3458, ISO 3501 dhe ISO 3503 (ose ekuivalente te tyre). Filetimi I tyre te jete sipas standartit ISO 7-1 (ose ekuivalent). Ndryshimi ne dimensionet e produkteve te jete maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kerkuara nga AK. Produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet ne menyre qe mos te krijojne alga ose baktere. Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet te jete homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit.

RAKORDERITE ZINGATO

Rakorderite sherbejne per lidhjen dhe/ose degezimin e nje tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi te tjera me permasa te njejta ose te ndryshme. Rakorderite duhet te jene material zingato i tipit EN-GJMW-400-5 (ose ekuivalent) dhe te kene te shkruar ne trup emrin e kompanise prodhuese ose marken. Ato duhet t'i rezistojne nje force minimalisht 35000 N/cm^2 pa u deformuar, dhe te kene rezistencen gradeformimi te pakten 210 HB. Te jene te mbuluar me zink ne sasi minimalisht 450 gr/m^2 dhe shtresa e zinkut mos te jete me e vogel se $65 \mu\text{m}$. Filetimi duhet te jene sipas standartit ISO228/1 ose ekuivalent. Presioni qe duhet te durojne te jete minimumi 25 bar ne temperaturen nga -20°C deri ne 100°C . Te gjithë produktet duhet te jene te certifikuara per perdorim ne uje te pijshem dhe te kene certifikate sanitare. Ato duhet te jene sipas standartit EN10242 (ose ekuivalent).

ELEKTROMANIKOTAT HDPE

Elektromanikotat duhet te jene te prodhuar me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastik te riclikuar. Ato duhet te jene konform standartit EN 12201-3 dhe ISO 4427 (ose ekuivalent). Dendesia e plastikës se perdorur duhet te jete 0.959 g/cm^3 sipas standartit ISO 1183 (ose ekuivalent). Moduli I terheqjes te jete minimumi 900 MPa sipas standartit ISO 527-2 (ose ekuivalent). Presioni I punes, I cili duhet te jete 16 bar, duhet te jete percaktuar ose vendosur sipas standartit EN 12201 (ose ekuivalent).

RAKORDERITE PER TUBO PEHD

Rakorderite per tubo PEHD perfshijne reduktues PE100, brryla 90 grade PE100, tap PE100, TEE PE100 dhe flanaxh adaptor PE100. Rakroderite duhet te jene te prodhuar me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastik te riclikuar. Ato duhet te jene konform standartit EN 12201-3 dhe ISO 4427 (ose ekuivalent). Dendesia e plastikes se perdorur duhet te jete minimumi 0.959 g/cm^3 sipas standartit ISO 1183(ose ekuivalent). Moduli I terheqjes te jete minimumi 900 MPa sipas standartit ISO 527-2 (ose ekuivalent). Presioni I punes, I cili duhet te jete minimumi 16 bar dhe te jete I percaktuar ose vendosur sipas standartit EN 12201 (ose ekuivalent). Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).

SARAQINESKA GIZE

Saraqineskat duhet te jene modeli G me filetim te boshtit qe sherben per kycjen dhe ckycjen e saraqineskes, ne pjesen e brendshme te saraqineskes . Testimi dhe dizenjimi I tyre ne perputhje me standartet EN1074 dhe EN1171 (ose ekuivalente). Dimensionet e saraqineskave duhet te jene sipas standarteve EN 558-1 dhe DIN3202 (ose ekuivalente). Lidhjet fundore te fllanxhave duhet te jene sipas standarteve EN1092-2 (ose ekuivalent). Temperatura e punes se saraqineskave te jete nga -10°C - $+70^{\circ}\text{C}$ (pranohet edhe diapazon me I gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Gjuheza, e cila ben te mundur bllokimin ose jo te rrjedhjes se ujit, duhet te jete e material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent) e kapsuluar ne gome EPDM qe lejohet per perdorim per uji te pijshem. Trupi I saraqineskes duhet te jete material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent). Boshti I saraqineskes te jete material I pandryshkshem inoks 1.4034 (ose ekuivalent) qe mos te kete ndikim ne ujin e pijshem per shkak te grryerjes nga uji. Saraqineskat duhet te jene te lyera ose te veshura me boje epokside minimum $250\mu\text{m}$. Dado dhe Bulonat te jene material inoks AISI304 (ose ekuivalent), ne menyre qe mos te ndikohen nga errozioni dhe te ndikojne ne mirefunksionimin e saraqinekses. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).

FLLANXHAT

Fllanxhat duhet te jene celiku te sheshta dhe sipas standartit 1092-1 (ose ekuivalent). Te gjitha fllanxhat duhet te kene presion pune 16bar.

SARAQINESKA ME FILETIM

Saracineskat duhet te jene me leve, prej bronxi, te punojne ne presion 25bar(ose me te larte) (pervec saracineskes 2 1/2" e cila duhet te jete minimumi 16 bar) Saracineska 2" ta kete gjatesine minimumi 100mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 35mm. Leva e

saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 110mm.

dhe ne temperature -15°C deri $+110^{\circ}\text{C}$. Saraqineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraqineskes duhet te kene filetimit femër dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjetër te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose I markes etj. Te jene te certifikuar per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Saraqineskave te kerkuara ne preventive jane:

Saracineska 2 1/2" ta kete gjatesine minimumi 134mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 60mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 225mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 132mm.

Saracineska 2" ta kete gjatesine minimumi 100mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 35mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 110mm.

Saracineska 1 1/2" ta kete gjatesine minimumi 85mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 33mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 100mm.

Saracineska 1 1/4" ta kete gjatesine minimumi 75mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 31mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 110mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 82mm.

Saracineska 1" ta kete gjatesine minimumi 65mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 29mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 70mm.

Saracineska 3/4" ta kete gjatesine minimumi 55mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 25mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 64mm.

Saracineska 1/2" ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 22mm. Leva e saraqineskes te jete minimumi 80mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 51mm.

Kundravalvulat

Kundralvalvula te jete material 100% bronx .Mekanizmi I bllokimit te rrjedhjes se ujit ne te kundert duhet te jete I veshur me gomine. Presioni i punes te jete minimumi 20 bar dhe temperatura e punes -10°C deri +110°C. Të dy fundet e kundralvalvules duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Kundralvalvula duhet te kete te shenuar te dhenat baze ne trup si madhesia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvalvulat duhe te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Kundralvalvulave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Kundralvalvula 2" ta kete gjatesine minimumi 84mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 36mm. Lartesia totale te jete minimumi 95mm.

Kundralvalvula 1 1/2" ta kete gjatesine minimumi 70mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 30mm. Lartesia totale te jete minimumi 80mm.

Kundralvalvula 1 1/4" ta kete gjatesine minimumi 65mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 28mm. Lartesia totale te jete minimumi 72mm.

Kundralvalvula 3/4" ta kete gjatesine minimumi 50mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 24mm. Lartesia totale te jete minimumi 55mm.

Kundralvalvula 1/2" ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 24mm. Lartesia totale te jete minimumi 45mm

Tubot PE100/PEHD

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Te jene sipas standartit EN 12201 ose ekuivalent me te. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos t'i japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me relievin e tokës.Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 derinë 55°C.Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet.

Pamja e jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, të jenë ngjyrë e zezë me vija blu, prejra fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit.

Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).

Fasheta Gize

Fasheta gize EN-GJS-500-7(ose ekuivalente) per tubo PE, PVC etj. Per te shmangur rrjedhjet, fashetat duhet te jene te veshura me gome izoluesese EPDM. Goma te jete e ngjitur pas trupit te fashetes. Dadot dhe bulonat duhet te jene material rezistent ndaj grryerjes, inoks AISI304 ose ekuivalent. Fashetat duhet te jene te lyera ose te veshura me boje epokside minimum 250µm. Presioni I punes se fashetave duhet te jete minimumi 10 bar.

Fasheta Inoksi

Fashetat e inoksit te jene inoks (AISI 304 sipas standartit EN 1.4301) ose ekuivalent. Gomina te jete e ngjitur me fasheten e inoksit me ngjites te perforcuar me fibra xhami per te pasur jetegjatesi dhe qendrueshmeri ndaj temperaturave te larta dhe lageshtise gjate montimit. Fashetat e inoksit te jene te certifikuara nga institucione nderkombetare per perdorim ne uje te pijshem dhe te jene te pajisura me certifikata te tipit ACS, WRAS, BS ose ekuivalente. Pjesa e gomuar e fashetes te jete gome EPDM,NBR ose ekuivalente te ketyre materialeve. Goma e perdorur ne fasheten e inoksit duhet te jete cilesi shume e larte sepse ka kontakt te drejtperdrejt me ujin e pijshem prandaj ajo duhet te jete per perdorim per uji te pijshem dhe te duroje temperatura deri 150 °C. Te mund te instalohen edhe nen presion pa pasur probleme(pjesa e daljes se filetuar te jete me tap qe mos te lejoj rrjedhjen e ujit deri ne momentin e deshiruar). Dalja e fashetes te jete sipas standartit ISO 7 (ose ekuivalent). Fashetat duhet te kene certifikate per perdorim per uji te pijshem si WRAS ose ekuivalente me te.

Fashetat PP

Fashetat sherbejne per krijimin e daljeve te sigurta ose linjave te reja ne tubat PE-HD sipas kerkeses se klientit. Trupi i fashetave te jete material Polipropilen me rezistence mekanike te larte. Te suportojne presionin 16 bar, dhe per kete te jene te testuara sipas standarteve ISO 17885(ose ekuivalente). Ndryshimi ne dimensionet e produkteve te jete maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kerkuara nga AK. Produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet ne menyre qe mos te krijojne alga ose baktere. Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet te jete homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit.

Dryna

Dryna te thjeshte. Ata duhet te jene te shoqeruar me celesat perkates. Te jene material bronzi qe mos te ndryshken. Drynat duhet te jene te dy madhesive te ndryshme, te medhenj dhe te vegjel.

Paste filetimi

Paste filetash hidraulike te jete e pershtatshme per punime hidraulike, te jete me dendesi 0,9-0,95 g/cm³ sipas standartit ASTM D1298 (ose ekuivalent), e patretshme ne uje dhe jo gerryese. Pika e ndezjes te jete me e larte se 230 C. Paketimi te jete minimumi 500g.

Shtang

Shtangat jane mjete ndihmese per hidrauliket ne terren qe sherbejne per komandimin ne distance te saraqineksave. Ato duhet te perputhen me boshtin komandues te kokat e saraqineksave dhe gjatesia e tyre te jete e pershtatshme per puntoret ne terren nga 130cm deri ne 180cm (pranohen edhe produkte me diapazone me te medha qe e perfshijne diapazonin e kerkuar).

Buketona

Buketonat sherbejne per te lidhur matesat me rrjetin shperndares. Duke qene se ato kane kontakt te drejtperdrejt me ujin duhet te jene te certifikuar per uji te pijshem. Per izolim me te mire te ujit, buketonat duhet te jene te shoqeruar me gominat perkatese.

Guarnicione

Guarnicionet duhet te jene material plastik te cilet nuk duhet te kene asnje ndikim negative mbi cilesine e ujit. Plastika e perdorur per prodhimin e tyre duhet te jete e certifikuar per uji te pijshem.

Rakorderite PPR

Rakorderite PPR perfshijne bashkuesa PPR, berryla 90 grade PPR, tap PPR, TEE PPR, adaptore PPR, berryll me fileto PPR. Trupi i rakorderive te jete material plastik PPR e paster dhe jo e perbere nga plastik te riclikuar. Rakorderite PPR duhet te jene konform standarteve DIN 16928

dhe DIN 4046(ose ekuivalente). Rakorderite duhet te jene te prodhuara ne menyre te tille qe ngjitja e tyre me material te tjera te behet sipas kerkesave standartit DVS 2207-11 (ose ekuivalente). Dendesia e plastikes te jete minimumi 0.894g/cm^3 . Moduli I elasticitetit te jete minimumi 780 N/mm^2 . Temperatura e shkrirjes te jete jo me e voges se 140 grade celcius. Rakorderite duhet te kene rezistence ndaj elementeve te ndryshem disifektues qe gjenden ne ujin qe shperndahet nga ujesjellesat si dhe elementet e tjere te zakonshem qe gjenden zakonisht ne uji. Ato duhet te jene rezistente ndaj elementeve si uji i klorinuar, bisulafat I karbonit, tetraklorur I karbonit, klorur kalciumi, nitrat kalciumi, klorur natriumi, bikarbonat natriumi etj. Produktet duhet të kenë certifikat të aprovimit nga të paktën 1 (një) institucion ndërkombëtar për përdorimin në ujë të pijshëm (p.sh DVGW) te vlefshme. Rakorderite duhet te kete te shenuar ne trupin e tyre minimumin perpasat e produkteve, presionin e punes, emrin e kompanise prodhuese ose emrin e markes etj.

Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).

Reduksione Gize

Reduksion ose ndryshe kon Gize (EN-GJS-500) sipas standartit DIN EN 1563 ose ekuivalent. Reduksionet te jene te pajisur me 2 flanaxha te levizshme dhe keto flanaxha te jene sipas standartit 1092-2 ose ekuivalent me te. Reduksionet te jene te pajtueshem me standartin EN545:2006 ose ekuivalent me te. Keto reduksionet duhet te jene te lyera me boje blu epokside te perdorshme per uje te pijshem RESICOAT 9000 R4 sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalente) dhe kjo boje te jete e aplikuar elektrostatikisht, me nje trashesi te barabarte ose me te madhe se $250\ \mu\text{m}$

Fllanxhe adaptore

Fllanxh adaptoret duhet te jene te prodhuar me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastik te riclikuar. Ato duhet te jene konform standartit EN 12201-3 dhe ISO 4427 (ose ekuivalent). Dendesia e plastikes se perdorur duhet te jete 0.959 g/cm^3 sipas standartit ISO 1183(ose ekuivalent). Moduli I terheqjes te jete minimumi 900 MPa sipas standartit ISO 527-2 (ose ekuivalent). Presioni I punes, I cili duhet te jete 16 bar, duhet te jete percaktuar ose vendosur sipas standartit EN 12201 (ose ekuivalent). Secili nga fllanxh adaptoret te jete I shoqeruar me fllanxhat perkatese sipas permasave te perventivit.

Fllanxhat per fllanxhe adaptore

Keto fllanxha duhet te kene unaze celiku te veshur me polypropilen te perforcuar me 30% fiberxhami. Duhet te jene per perdorim te brendshem dhe te jashtem. Fllanxhat dhe vrimat per dadobulonat duhet te suportojne presionin e punes PN 16. Dimensionet e fllanxhave dhe lidhja e tyre me pajisje te tjera ose ne sistem duhet te jete sipas standarteve ISO 7005, EN 1092, BS 4504, DIN 2501 (ose ekuivalente).

Kesula gize

Kesulat jane konstruksione metalike qe sherbejne per mbulimin e instalimeve nentokesore te saraqineskave dhe hidranteve. Ato duhet te jene material gize dhe ne forme cilindrike.

Elektroda

Elektrodat e saldimit te celikut duhet te jene konform standartit EN ISO 2560-A (ose ekuivalent). Elektrodat duhet te kene aprovim nga nje ose disa institucione te cilat vertetojne qe ato jane sipas standarteve te bashkimit europian. Perberja kimike e elektrodave duhet te jete sipas vlerave te meposhtme:

Karboni nga 0.65% deri ne 0.72%, Mangani nga 1.45% deri ne 1.5%, Silici te jete maksimumi 0.5%, Fosfori te jete maksimumi 0.02%, Sulfuri dhe Molibdeni te jene maksimumi 0.01% secili, Kromi, Nikeli dhe Bakri te jene me pak se 0.05% secili. Forca qe duhet te duroje saldimi pa pesuar asnje ndryshim ose thyerje duhet te jete 450 N/mm² (ose me e madhe).

Permasat e Elektrodave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Elektroda 3.2mm, Elektroda 2.5mm

Elektroda inoksi

Elektrodat e saldimit te inoksit duhet te jene konform standartit EN 3581-A (ose ekuivalent). Elektrodat duhet te kene aprovim nga nje ose disa institucione te cilat vertetojne qe ato jane sipas standarteve te bashkimit europian. Perberja kimike e elektrodave duhet te jete sipas vlerave te meposhtme:

Karboni nga 0.14% deri ne 0.18%, Mangani nga 4.5% deri ne 7.5%, Silici te jete maksimumi 1%, Fosfori te jete maksimumi 0.04%, Sulfuri te jete maksimumi 0.03%, Kromi te jete nga 18% deri ne 21%, Nikeli te jete nga 7% deri ne 11%, ferrite nga 5% deri ne 10%. Forca qe duhet te duroje saldimi pa pesuar asnje ndryshim ose thyerje duhet te jete 350 N/mm² (ose me e madhe).

Permasat e Elektrodes jane 3.2mm

Flete guri fresibel

Flete guri fresibel është një material rrethor prerës. Guri prerës shërben për prerjen e tubove metalike dhe tubove plastike të dimensioneve të mëdha.

Litar Lini

Litar i linit është një element ndihmes për forcimin e lidhjeve të rakorderive me fileto ndërmjet njëra-tjetres dhe minimizon shancet që të ketë rrjedhje uji gjatë këtyre lidhjeve.

Mates Uji 1/2" (horizontal dhe vertikal)

Matesi i ujit për uje të ftohtë duhet të jetë sipas standarteve të Bashkimit Europian 2014/32/EU ose kerkesave të MID (ose ekuivalent).

Matesi duhet të jetë i certifikuar për përdorim për ujë të pijshëm dhe kjo të vertetohet me certifikatat perkatese.

Numrat e në fushën e matesit që tregojnë matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të mbyllur në mënyrë hermetike, në një kase që nuk krijon kondensim për të penguar leximin dhe të jenë të ndara në 2 ngjyra (5 numra me të njëjtën ngjyrë që tregojnë m³ dhe tre numra me një ngjyrë tjetër që tregojnë nënfishat e m³). Matesi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar levizjen e lirë të numratorit.

Matesi i ujit duhet të ofrojë mundësinë dhe të jetë kompatibel me teknologjinë e Leximit Automatik të Matesit, të suportojë vendosjen e një moduli transmetues të të dhënave me vlerë në përputhje me standardin EN 13757-4 ose ekuivalent. Moduli i leximit të matesit në distancë është pa kabell (wireless) dhe transmetimi i të dhënave të jetë i enkriptuar në mënyrë të tillë që informacioni të mos aksesohet nga persona të pa autorizuar, sipas protokollit AES-128 dhe algoritmit CBC. Moduli të ofrojë mundësinë për alarm në rast të përdorimit të fushave manjetike, dritës të fortë për të manipuluar leximin e sensorit. Të lajmërohet në rast se persona të pa autorizuar shkepusin modulën nga matesi, në rast se ka këthim uji, rrjedhje uji etj. Bateria e modulit të ketë jetëgjatësi të pakten 9 vjet, frekuencë e transmetimit të jetë 868 - 869MHz, fuqia e transmetimit të pakten 10mW dhe distanca e transmetimit të pakten 350m në fushë të hapur. Moduli i leximit të ketë shkallë mbrojtje IP68 ose më të lartë. Moduli duhet të ndërveprojë me pajisje portabel për mbledhjen e të dhënave. Pajisja të kryejë mbledhjen e të dhënave nga matesat e ujit në një distancë deri në 350m dhe të bëjë të mundur kalimin e të dhënave me teknologji pa kabell (wireless). Gjithashtu kjo pajisje të ofrojë mundësinë për konfigurimin e moduleve të matesave. Mekanizmi i matesit duhet të ketë minimalisht mbrojtje të trefishtë manjetike për siguri sa më të lartë dhe një matje sa më të mirë kundrejt interferencave të fushave manjetike të jashtme ose të brendshme. Gjithashtu leximi i të dhënave duhet të kryhet anë të një lexuesi optik dhe jo me puls manjetik, në mënyrë të tillë që përdoruesit të mos kenë mundësi të ndalojnë leximin e matesit me anë të përdorimit të magnetëve. Duke pasur parasysh se percimi i rrotullimit të turbines të matesit drejt mekanizmit të matjes bëhet me anë të fushës magnetike, matesat e ofruar duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj ndërprerjes të transmetimit të rrotullimeve, si dhe fusha e matesit të ofrojë mundësinë për të rrotulluar 360°, në mënyrë që të bëhet leximi sa më i thjeshtë, por jo më shumë se 360°.

Buketonat per matesat DN 15 te kene diameter te brendshem 15-18mm dhe gjatesi 37-40mm. Per matesat DN20 te kene diameter te brendshem 20-23mm dhe gjatesi 45-50mm. Buketonat te jene te certifikuar per perdorim ne uje te pijshem.

Matesi te jete i pajisur me teknologjine kunder ngrirjes, ne menyre qe dhe nese uji ne te ngrin nga temperaturat e ulta, ai te mos demtohet.

Mates uji DN 15					
Diametri i matesit DN			mm	15	
Rrjedha e perhershme Q3			m ³ /h	2.5	
Rrjedha maksimale Q4			m ³ /h	3.125	
Rrjedha indirekte Q2	Montim horizontal	R100	l/h	40	
	Montim vertikal	R50		80	
Rrjedha minimale Q1	Montim horizontal	R100	l/h	25	
	Montim vertikal	R50		50	
Rrjedha fillestare			l/h	8	
Raporti Q2/Q1				1.6	
Temperatura nominale e punes				T30	
Klasa e ndjeshmerise se tipeve te rrjedhjes				U0, D0	
Rregjistrimi maksimal			m ³	100 000	
Rregjistrimi minimal			l	0.05	
Presioni			bar	16	
Humbja maksimale per Q3 Δp			kPa	63	
Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4			%	± 2	
Madhesia e filetimit				G $\frac{3}{4}$	G1

Mates uji 1“

Matesi i ujit per uje te ftohte duhet te jete sipas standarteve te Bashkimit European 2014/32/EU ose kerkesave te MID (ose ekuivalent).

Matesi duhet te kete mbrojte te klasit IP 68 ose ekuivalente me te.

Matesi duhet te jete i certifikuar per perdorim per ujit te pijshem.

Matesi duhet te kete ekran dixhital per shfaqjen e te dhenave te matura dhe te kete te inkorporuar modulim radio (jo te mbivendosur, pra te jene nje trup) per leximin e te dhenave ne distance nepermjet transmetimit te te dhenave sipas protokolleve OMS ose ekuivalente me te.

Matesi duhet te jete metalik dhe te punoje minimumi 15 vjet me bateri pa perdorur opsionin e transmetimit te te dhenave me vale sipas protokolleve EN 13757-4 ose ekuivalent ,OMS ose ekuivalente me te dhe minimumi 11 vjet ne rastin kur transmeton te dhenat me vale. Bateria e matesit duhet te jete e zevendesueshme ne menyre qe matesi te mund te perdoret dhe per me gjate se 11 vjet. **Saktesia e matjes te ujit te jete R sipas tabelës së mesiperme ku janë listuar matesat objekt prokurimi.**

Kushtet klimaterike qe duhet te suportojte matesi duhet te jene sipas standartit EN - ISO 4064:2014 ose ekuivalente me te.

Nepermjet transmetimit te te dhenave me vale matesi duhet te transmetojte edhe alarme ne lidhje me: Baterine (kur bateria eshte drejt shkarkimit te plote), Nderhyrje per manipulim te dhenash(heqjen e matesit te ujit nga sistemi ne menyre te pa-autorizuar), rrjedhje te vogla te ujit, rrjedhje shume te medha te ujit (mbi limitin e matesit), kur ka sasi te medha ajri ne uje, kur ska uje etj.

Bazamenti i matesit ku kalon uji te jete plotesisht i hapur ne menyre qe te mos ndikohet nga papastertite qe mund te kete uji dhe elementet mates te tij te jene te mbrojtur nga cdo lloj demtimi.

Matesi te ofroje mundesine per tu konfiguruar dhe ricertifikuar me ane te komunikimit valor. Gjithashtu matesi te ofroje mundesine qe te lexohet historiku I te dhenave dhe gabimeve me ane te nje smartphone, ose paisje tjeter ekuivalente.

Diametri nominal	DN	mm	25
Rrjedhja e vazhdueshme	Q3	m ³ /h	6.3
Rrjedhja e mbingarkaur	Q4	m ³ /h	7.87
Rrjedhja tranzite	Q2	dm ³ /h	12.6
Rrjedhja minimale	Q1	dm ³ /h	7.87
Niveli I fillimit te matjes	-	dm ³ /h	1.89
Raporti I matjes	R	Q3/Q1	800 ose me te larte ne te gjithë pozicionet e instalimitH;V;H/

				V
Raporti		Q2/Q1		1.6
Klasi I temperatures per EN ose OIML		°C		T30,T50
Klasi I imunitetit per crregullime rrjedhje per EN		-		U0,D0
Raporti tregues I numeruesit		m3		10^6
Intervali I tanishem I ndarjes		dm3		0.01
Gabimi maksimal I lejuar ne rang: Q2≤Q≤Q4	ε	%		±2 per uje te ftohte T≤30°C ±3 per uje T>30°C
Gabimi maksimal I lejuar ne rang: Q1≤Q≤Q2	ε	%		±5
Klasi I presionit te ujit	Sipas EN	-	bar	MAP16
	Sipas OIML	-	bar	16
Klasi I humbjes te presion per rrjedhjen Q3	Sipas EN	ΔP	bar	ΔP0.4
	Sipas OIML		bar	0.4
	nga prodhuesi		bar	0.28
Pozicioni I montimit			-	H; V; H/V
Rrjedhja mbrapa sipas prodhuesit			-	Matesi I ujit I dedikuar per matjen e rrjedhjes mbrapa
Lageshtira relative			%	≤100
Klasi I izolimit IP			-	IP68
Materjali I trupit			-	Bronx
Filetot ne dalje	G		inc	1 1/4"

=====